


Komuna e Podujevës

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Podujevës
Municipality of Podujevo
Opstina Podujevo

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation



Prishtinë, 20/07/2026

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura; Ligjin Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Ligjin Nr. 08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike; Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Neni 20 i Rregullores (QRK) Nr. 05/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive; aktet nënligjore në fuqi për administrimin, menaxhimin dhe shfrytëzimin e parqeve industriale dhe teknologjike; Ligjin Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Palët lidhin këtë Marrëveshje:

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “PARKU I PËRGJITHSHËM NË LIVADICË TË PODUJEVËS”

E lidhur ndërmjet:

1. Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, e përfaqësuar nga Ministria, në tekstin e mëtejshëm: “MINTI”; dhe
2. Komunës së Podujevës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, në tekstin e mëtejshëm: “Komuna”.

MINTI dhe Komuna, në tekstin e mëtejshëm së bashku: “Palët”,

Neni 1

Qëllimi dhe objekti i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje rregullon bashkëfinancimin, ndarjen e përgjegjësisë, prokurimin, menaxhimin e projektit, zbatimin e punimeve, monitorimin, pagesat, pranimin teknik, dorëzimin dhe hapat për funksionalizimin e Projektit “Parku i Përgjithshëm në Livadicë të Podujevës” (në tekstin e mëtejshëm: “Projekti”).
2. Projekti realizohet sipas projektit të aprovuar, paramasës dhe parallogarisë, dokumenteve të tenderit, kontratës publike dhe ndryshimeve të lejuara sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kjo Marrëveshje përcakton marrëdhëniet ndërmjet Palëve dhe nuk zëvendëson kontratën publike me operatorin ekonomik, lejen e ndërtimit, pëlqimet teknike, vendimin për themelimin e Parkut apo aktet e tjera të nevojshme ligjore.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, shprehjet në vijim kanë këtë kuptim:
 - 1.1. “Kontrata” – kontrata publike e lidhur pas përfundimit të procedurës së prokurimit për realizimin e punimeve të Projektit;
 - 1.2. “Fillimi i punimeve” – data e përcaktuar në urdhrin me shkrim për fillimin e punimeve, të lëshuar sipas Kontratës nga autoriteti kontraktues ose Menaxheri i Projektit;
 - 1.3. “Viti i parë i planifikuar” – viti fiskal në të cilin lëshohet urdhri për fillimin e punimeve; “Viti i dytë” dhe “Viti i tretë” janë dy vitet fiskale pasuese;
 - 1.4. “Menaxheri i Projektit” – zyrtari i caktuar me vendim nga MINTI për menaxhimin e Kontratës dhe koordinimin e zbatimit të Projektit;
 - 1.5. “Koordinatori Komunal” – zyrtari i caktuar me vendim nga Komuna për koordinim me MINTI-n dhe për përcjelljen e zbatimit të Projektit në nivel komunal;
 - 1.6. “Mbikëqyrësi” – personi fizik ose juridik i angazhuar ose i caktuar në pajtim me legjislacionin dhe Kontratën për mbikëqyrjen profesionale të punimeve;
 - 1.7. “Situacioni” – dokumenti financiar dhe teknik për punët e realizuara, i verifikuar dhe certifikuar sipas Kontratës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Vlera dhe financimi i Projektit

1. Vlera totale e Projektit, e përcaktuar sipas rezultatit të procedurës së prokurimit, është 3,118,295.56 euro (tre milionë e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë euro e gjashtëdhjetë cent).

2. MINTI siguron financimin e plotë të Projektit, në masën njëqind për qind (100%) të vlerës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. MINTI, në cilësinë e autoritetit kontraktues, kryen të gjitha pagesat ndaj operatorit ekonomik për punët e realizuara, të verifikuara, të certifikuara dhe të pranuar në përputhje me Kontratën dhe legjislacionin në fuqi.
4. Komuna nuk merr përsipër asnjë detyrim financiar për financimin e Projektit dhe nuk kryen pagesa ndaj operatorit ekonomik.
5. Çdo rritje eventuale e vlerës së Projektit ose krijim i një detyrimi financiar shtesë lejohet vetëm nëse është në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, sigurohen ndarjet e nevojshme buxhetore nga MINTI dhe ndryshimi formalizohet sipas procedurave ligjore.
6. Nëse krijohen kosto shtesë si pasojë e veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm, fajtor ose të pajustificuar të njërës Palë, përgjegjësia për këto kosto përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Planifikimi dhe ndarja e mjeteve financiare

1. MINTI planifikon dhe ndan mjetet financiare për realizimin e Projektit për tri (3) vite fiskale radhazi, duke filluar nga viti fiskal në të cilin lëshohet urdhri për fillimin e punimeve.
2. Pagesat realizohen vetëm për punët e kryera dhe të certifikuara, sipas dinamikës së Kontratës dhe fondeve të alokuara.
3. Para lëshimit të urdhit për fillimin e punimeve, MINTI siguron ndarjen dhe alokimin buxhetor për vitin e parë, si dhe planifikimin e mjeteve për dy vitet pasuese në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve ose në dokumentet përkatëse të planifikimit buxhetor.
4. Në rast se dinamika e realizimit të punimeve ndryshon nga planifikimi vjetor, MINTI ndërmerr procedurat e nevojshme për rishikimin, riprogramimin ose rialokimin e mjeteve, në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.
5. Kontrata shumëvjeçare dhe ndryshimet e saj i raportohen Thesarit sipas legjislacionit në fuqi. Asnjë pagesë nuk bëhet pa ndarje, zotim dhe alokim të vlefshëm buxhetor nga MINTI.

Neni 5

Përgjegjësitë e MINTI-t

1. MINTI ka përgjegjësitë e mëposhtme:
 - 1.1. siguron, planifikon dhe ekzekuton financimin e plotë të Projektit, në vlerë totale prej 3,118,296.56 euro;
 - 1.2. udhëheq të gjitha procedurat e prokurimit publik dhe vepron si autoritet kontraktues për Kontratën, në pajtim me legjislacionin e prokurimit publik;
 - 1.3. cakton me vendim Menaxherin e Projektit dhe, sipas nevojës, zëvendësuesin e tij;
 - 1.4. siguron që udhëzimet ndaj operatorit ekonomik të jepen vetëm përmes personave të autorizuar sipas Kontratës;
 - 1.5. i siguron Komunës kopje të Kontratës, anekseve, planit dinamik, raporteve të progresit, situacioneve të certifikuara dhe dokumenteve të tjera që lidhen me zbatimin e Projektit, me përjashtim të informatave të mbrojtura me ligj;
 - 1.6. fton Komunën në pjesëmarrje për planin e punës, vizitat në terren, identifikimin e rreziqeve, masat korrigjuese dhe pranimin e punimeve;

- 1.7. fton Komunën në monitorimin e progresit fizik dhe financiar, evidentimin e problemeve dhe verifikimin e përmbushjes së objektivave të Projektit;
- 1.8. siguron që zbatimi i Projektit, brenda kompetencave të MINTI-t, të jetë në pajtim me legjislacionin për parqet industriale dhe teknologjike, prokurimin publik dhe financat publike;
- 1.9. Menaxheri i projektit dhe mbikëqyrësi i kontratës, me përgjegjësi të plotë, vërtetojnë sasinë, cilësinë dhe kualitetin e punëve dhe furnizimeve të kryera, në bazë të të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentacionin financiar për realizimin e pagesës, në përputhje me kushtet e kontratës.
- 1.10. Ministria i kryen pagesat për Operatorin Ekonomik, pas pranimi të punëve dhe furnizimeve, sipas raportit të përfunduar nga Menaxheri i kontratës, përkatësisht Komisioni i Pranimi teknik, me rastin e përfundimit të punimeve, i themeluar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Përgjegjësitë e Komunës

1. Komuna ka përgjegjësitë e mëposhtme:
 - 1.1. Garanton se prona ku realizohet Projekti ka pronësi të qartë, nuk është objekt kontesti dhe vihet në dispozicion të Projektit pa pengesa juridike ose faktike;
 - 1.2. siguron dhe mban të vlefshme lejen e ndërtimit, kushtet ndërtimore, pëlqimet komunale, mjedisore, infrastrukturore dhe të shërbimeve publike, si dhe dokumentet e tjera që ligji ia ngarkon Komunës ose pronarit të lokacionit;
 - 1.3. dorëzon projektin e aprovuar, paramasën dhe parallogarinë, matjet, të dhënat kadastrale, studimet, pëlqimet dhe dokumentet teknike të nevojshme për zbatimin e punimeve;
 - 1.6. cakton me vendim Koordinatorin Komunal dhe përfaqësuesit teknikë që bashkëpunojnë me Menaxherin e Projektit;
 - 1.7. siguron qasjen e papenguar në lokacion, koordinon me ndërmarrjet publike dhe operatorët e rrjeteve dhe zgjidh me prioritet çështjet lokale që mund të shkaktojnë vonesa;
 - 1.8. koordinon me MINTI-n planin e punës, vizitat në terren, identifikimin e rrezeve, masat korrigjuese dhe pranimin e punimeve;
 - 1.9. ndihmon MINTI-n në monitorimin e progresit fizik dhe financiar, evidentimin e problemeve dhe verifikimin e përmbushjes së objektivave të Projektit;
 - 1.10. merr pjesë në pranimin teknik, pranimin e përkohshëm, pranimin përfundimtar dhe dorëzimin e dokumentacionit të Projektit;
 - 1.11. pas dorëzimit, siguron ruajtjen, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e përkohshme të infrastrukturës në lokacion, deri në fillimin e administrimit dhe menaxhimit sipas ligjit.

Neni 7

Koordinimi ndërinstitucional

1. Për zbatimin operacional të Marrëveshjes, secila Palë cakton së paku dy (2) përfaqësues. Përfaqësuesit formojnë ekipin koordinues të Projektit.
2. Ekipi koordinues nuk është organ vendimmarrës dhe nuk mund të ndryshojë Kontratën, vlerën e Projektit, raportin e financimit nga MINTI ose kompetencat ligjore të Palëve.
3. Ekipi koordinues mbledhet së paku një herë në muaj gjatë zbatimit të punimeve dhe sa herë që kërkohet nga Menaxheri i Projektit ose Koordinatori Komunal.

4. Për çdo takim hartohet procesverbal, i cili përmban progresin, çështjet e hapura, personin përgjegjës, afatin për veprim dhe vendimet ose rekomandimet e dakorduara.

Neni 8

Faza përgatitore

1. Brenda njëzetë (20) ditëve të punës nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Palët shkëmbejnë dokumentet e listuara në Shtojcën 1, për aq sa ato janë të zbatueshme dhe të disponueshme.
2. Para fillimit të punimeve, Palët nënshkruajnë procesverbalin e gatishmërisë për fillim, me të cilin konfirmohet:
 - 2.1. vlefshmëria e dokumentacionit teknik dhe lejeve;
 - 2.2. qartësia e pronësisë dhe qasja në lokacion;
 - 2.3. caktimi i Menaxherit të Projektit, Koordinatorit Komunal dhe Mbikëqyrësit;
 - 2.4. sigurimi i kontratës, sigurimet, plani dinamik dhe plani i menaxhimit të sigurisë;
 - 2.5. gatishmëria e rrjeteve dhe pëlqimeve të nevojshme për kyçje.
3. Nëse mungon një dokument ose kusht thelbësor, urdhri për fillimin e punimeve nuk lëshohet deri në plotësimin e tij, përveç kur ligji dhe Kontrata lejojnë shprehimisht fillimin e pjesshëm.

Neni 9

Faza e prokurimit dhe kontraktimit

1. MINTI udhëheq dhe përfundon procedurën e prokurimit, nënshkruan Kontratën dhe administron komunikimin kontraktual me operatorin ekonomik.
2. Komuna ofron mbështetje teknike dhe sqarime për dokumentacionin e Projektit, pa ndërhyrë në kompetencat e komisioneve të prokurimit ose në pavarësinë e procesit të vlerësimit.
3. Çdo aneks i Kontratës, punë shtesë, ndryshim sasie, zgjatje afati ose ndryshim tjetër kontraktual miratohet vetëm nga MINTI, pas përmbushjes së kërkesave ligjore, teknike dhe financiare.

Neni 10

Fillimi dhe zbatimi i punimeve

1. Data e urdhrit për fillimin e punimeve aktivizon planin trevjeçar të financimit sipas nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje.
2. Punimet realizohen sipas Kontratës, projektit të aprovuar, standardeve teknike, lejeve, planit dinamik dhe rregullave për sigurinë, shëndetin në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.
3. Operatori ekonomik paraqet planin e detajuar të punimeve, planin e furnizimeve dhe parashikimin mujor financiar. Menaxheri i Projektit ia përcjell këto dokumente Komunës për informim dhe koordinim.
4. Komuna siguron që punimet të mos pengohen nga çështjet pronësore, qasja në lokacion, rrjetet ekzistuese, lejet komunale ose veprimet e organeve komunale.
5. Çdo pezullim ose ndërprerje e punimeve evidentohet me shkrim, duke përcaktuar shkakun, përgjegjësinë, masat për rifillim dhe ndikimin e mundshëm financiar e kohor.

Neni 11

Menaxhimi, mbikëqyrja dhe raportimi

1. Menaxheri i Projektit është pika zyrtare e kontaktit me operatorin ekonomik dhe ushtron kompetencat e menaxhimit të Kontratës. Komuna nuk i jep operatorit ekonomik urdhra të drejtpërdrejtë, por kërkesat dhe vërejtjet i adreson përmes Menaxherit të Projektit.

2. Koordinatori Komunal ka të drejtë të marrë pjesë në vizitat në terren, takimet e progresit, verifikimin e punëve dhe procedurat e pranimit, si dhe të paraqesë vërejtje të arsyetuara me shkrim.
3. Mbikëqyrësi verifikon cilësinë, sasitë, përputhshmërinë me projektin dhe standardet teknike dhe i raporton Menaxherit të Projektit sipas Kontratës.
4. Menaxheri i Projektit përgatit raport mujor, i cili përmban së paku:
 - 4.1. progresin fizik dhe financiar;
 - 4.2. punët e realizuara dhe situacionet e paraqitura;
 - 4.3. devijimet nga plani dinamik dhe shkaqet e tyre;
 - 4.4. rreziqet, pengesat dhe masat korrigjuese;
 - 4.5. çështjet që kërkojnë veprim nga MINTI ose Komuna;
 - 4.6. fotografi dhe dokumente mbështetëse nga terreni.
5. Komuna i paraqet komentet e saj mbi raportin ose situacionin brenda pesë (5) ditëve të punës nga pranimi. Mosparaqitja e komenteve nuk zëvendëson certifikimin teknik, por nuk e pezullon procedimin e dokumenteve që janë të plota dhe të certifikuara sipas Kontratës.

Neni 12

Pagesat dhe kontrolli financiar

1. Pagesat ndaj operatorit ekonomik procedohen nga MINTI si autoritet kontraktues, mbi bazën e faturës, situacionit të certifikuar, raportit të Mbikëqyrësit dhe aprovimit të Menaxherit të Projektit.
2. Pagesat kryhen nga ndarjet buxhetore të MINTI-t dhe vetëm mbi bazën e faturës së rregullt, situacionit të verifikuar dhe certifikuar, raportit të Mbikëqyrësit, aprovimit të Menaxherit të Projektit, raportit të pranimit dhe dokumenteve të tjera të kërkuara nga Kontrata dhe legjislacioni financiar në fuqi.
3. Komuna nuk kryen pagesa ndaj operatorit ekonomik, nuk financon asnjë pjesë të Projektit dhe nuk lëshon urdhër blerje ose dokument tjetër financiar lidhur me Kontratën.
4. MINTI regjistron dhe mban evidencën e plotë të zotimeve, obligimeve, faturave, situacioneve, pagesave dhe bilancit të mbetur të Kontratës.
5. Palët u sigurojnë Auditorit të Përgjithshëm, auditimit të brendshëm, Thesarit dhe organeve të tjera kompetente qasje në dokumentacionin financiar, teknik dhe kontraktual të Projektit, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore.

Neni 13

Ndryshimet, punët shtesë dhe zgjatja e afatit

1. Ndryshimi i fushëveprimit, sasive, vlerës, afatit ose zgjidhjes teknike lejohet vetëm kur është i arsyetuar, i dokumentuar nga Menaxheri i kontratës dhe në pajtim me legjislacionin e prokurimit publik dhe Kontratën.
2. Propozimi për ndryshim duhet të përmbajë arsyetimin teknik, ndikimin financiar, burimin e financimit, ndikimin në afat, vlerësimin e rrezikut dhe konfirmimin se ndryshimi nuk cenon qëllimin e Projektit.

Neni 14

Pranimi teknik, dorëzimi dhe asetet

1. Pas përfundimit të punimeve, organizohet kontrolli teknik dhe pranimi i përkohshëm sipas legjislacionit dhe Kontratës. Në proces marrin pjesë përfaqësuesit e MINTI-t, Komunës, Menaxheri i Projektit, Mbikëqyrësi dhe subjektet e tjera kompetente.

2. Mangësitë evidentohen në procesverbal me afat për eliminim. Pranimi përfundimtar bëhet vetëm pas eliminimit të mangësive, dorëzimit të dokumentacionit të plotë dhe përmbushjes së kushteve të garancisë sipas Kontratës.
3. Operatori ekonomik dorëzon së paku projektin e gjendjes së realizuar, a-testet dhe certifikatat, manualët, garancitë, procesverbalet e testimit, evidencën e materialeve dhe dokumentet e tjera të kërkuara.
4. Me procesverbal të veçantë përcaktohen dorëzimi fizik, përgjegjësia për ruajtje dhe mirëmbajtje, regjistrimi kontabël dhe juridik i aseteve dhe dokumentacioni që i dorëzohet administruesit. Kjo Marrëveshje nuk bart automatikisht pronësinë e aseteve pa aktin përkatës të dorëzimit dhe regjistrimit.
5. Komuna, si pronare e lokacionit, siguron mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e përkohshme të infrastrukturës së përfunduar deri në fillimin e administrimit dhe menaxhimit të Parkut sipas ligjit.

Neni 15

Administrimi, menaxhimi dhe funksionalizimi i Parkut

1. Pas përfundimit të Projektit, administrimi i Parkut organizohet në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike dhe aktet nënligjore në fuqi.
2. Kur investimi bëhet nga Qeveria, AIPNK së bashku me propozuesin për themelimin e Parkut ushtron administrimin, përveç nëse me akt të kompetentit përcaktohet ndryshe në pajtim me ligjin.
3. Menaxhuesi i Parkut përzgjidhet në mënyrë transparente sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ për administrimin dhe menaxhimin e parqeve industriale dhe teknologjike.
4. Përzgjedhja e shfrytëzuesve, kontratat e shfrytëzimit, qiraja, shërbimet, regjistri dhe monitorimi rregullohen me ligj dhe akte të veçanta. Kjo Marrëveshje nuk përcakton ndarjen e të hyrave nga qiraja ose modelin përfundimtar të menaxhimit.
5. Palët bashkëpunojnë për regjistrimin e Parkut, promovimin, lidhjen me rrjetet dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme që Parku të bëhet funksional dhe i gatshëm për vendosjen e shfrytëzuesve.

Neni 16

Pronësia e projektit

1. Deri në momentin e pranimi përfundimtar të pasurisë jo financiare, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, si organizatë buxhetore financuese, do të regjistrojë shpenzimet përkatëse në kategorinë e investimeve në vijim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Pas përfundimit të punëve dhe furnizimeve, si dhe pas realizimit të pranimi teknik në përputhje me kushtet e kontratës, Ministria do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim, pas realizimit të pagesës finale për projektin.
3. Komuna e Podujevës, si organizatë buxhetore pranuese, obligohet që pasurinë jo financiare të realizuar në kuadër të këtij projekti ta regjistrojë në regjistrat e saj të pasurisë jo financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e pasurisë publike, pa pasur të drejtë në ndryshim të destinimit.

Neni 17

Dokumentacioni, transparencia dhe integriteti

1. Palët mbajnë dhe ruajnë dokumentacionin e Projektit për periudhën e përcaktuar me ligj dhe sigurojnë gjurmë të plotë audituese për çdo vendim, pagesë dhe ndryshim.
2. Palët zbatojnë parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, ekonomikitetit, efikasitetit, llogaridhënies dhe parandalimit të konfliktit të interesit, keqpërdorimit dhe korrupsionit.
3. Informatat e klasifikuara, të dhënat personale dhe sekretet afariste trajtohen sipas legjislacionit në fuqi. Kjo dispozitë nuk kufizon të drejtën e organeve të auditimit dhe kontrollit për qasje në dokumente.

Neni 18

Komunikimi zyrtar

1. Njoftimet, kërkesat dhe aprovimet sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim, përmes protokollit zyrtar ose postës elektronike zyrtare të personave të autorizuar.
2. Palët i njoftojnë njëra-tjetrën brenda pesë (5) ditëve të punës për çdo ndryshim të personave kontaktues ose të të dhënave të komunikimit.
3. Komunikimi operacional nuk mund të ndryshojë këtë Marrëveshje ose Kontratën pa respektimin e formës dhe procedurës së paraparë me ligj.

Neni 19

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje zgjatë deri në dorëzimin përfundimtar të Projektit dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët.
2. Mungesa e një afati kalendarik për përfundimin e kësaj Marrëveshjeje nuk ndryshon afatet e Kontratës, planin trevjeçar të financimit të Projektit nga MINTI ose afatet ligjore për kryerjen e veprimeve të caktuara.
3. Detyrimet e MINTI-t për financimin dhe pagesën e Projektit, si dhe detyrimet e Palëve për zbatimin, pranimin, dorëzimin, raportimin dhe auditimin, mbeten në fuqi deri në përmbushjen e tyre të plotë.

Neni 20

Pezullimi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë me pajtim të ndërsjellë me shkrim, pas përcaktimit të ruajtjes së aseteve.
2. Njëra Palë mund të kërkojë përfundimin për shkelje thelbësore nga Pala tjetër, vetëm pasi ta ketë njoftuar me shkrim dhe t'i ketë dhënë afat prej tridhjetë (30) ditësh për evitimin e shkeljes, përveç kur shkelja nuk mund të evitohet.
3. Përfundimi ose pezullimi i kësaj Marrëveshjeje nuk i cenon obligimet e krijuara ligjërisht ndaj operatorit ekonomik, detyrimet për pagesat e certifikuara, përgjegjësinë për dëmet dhe detyrimet e auditimit e dokumentimit.
4. Në rast të pamundësisë ligjore, forcës madhore ose vendimit të organit kompetent që e bën të pamundur vazhdimin e Projektit, Palët hartojnë planin e mbylljes, mbrojtjes së punimeve dhe trajtimit të obligimeve të mbetura.

Neni 21

Ndryshimi dhe plotësimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje ndryshohet ose plotësohet vetëm me aneks të shkruar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja Palëve.
2. Aneksi nuk mund të krijojë detyrim financiar pa ndarje të miratuar buxhetore dhe nuk mund të legalizojë ndryshim të Kontratës që nuk lejohet nga legjislacioni i prokurimit publik.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët përpiqen t'i zgjidhin mosmarrëveshjet përmes konsultimeve dhe negociatave institucionale brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi me shkrim për mosmarrëveshjen.

Neni 22

Dispozitat kalimtare dhe zëvendësuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, zëvendësohet Marrëveshja e Bashkëpunimit për Projektin "Parku i Përgjithshëm në Livadicë të Podujevës", e datës 03.05.2024 me numër protokoli 2224/01.
2. Veprimet e ndërmarra ligjërisht, procedura e prokurimit, dokumentet teknike dhe të drejtat e krijuara para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje mbeten të vlefshme, përveç pjesëve që ndryshohen shprehimisht me këtë Marrëveshje ose me akt tjetër të ligjshëm.
3. Në rast mospërputhjeje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës me operatorin ekonomik, Kontrata rregullon marrëdhënien me operatorin ekonomik, ndërsa kjo Marrëveshje rregullon marrëdhënien ndërmjet MINTI-t dhe Komunës, gjithmonë në pajtim me ligjin.

Neni 23

Dispozitat përfundimtare

1. Shtojca 1 është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në katër (4) ekzemplarë origjinalë, nga dy (2) ekzemplarë për secilën Palë.

PËR MINTI-n


Mimoza Kusari Lila
Ministre në detyrë
Data: 20.07.2026


PËR KOMUNËN E PODUJEVËS


Shpëtim Bulliqi
Kryetar i Komunës
Data: 20.07.2026


SHTOJCA 1
LISTA MINIMALE E DOKUMENTEVE PARA FILLIMIT TË PUNIMEVE

1. Vendimi ose akti për themelimin e Parkut dhe dokumentet bazë të iniciimit;
2. Certifikata e pronësisë, kopja e planit, koordinatat dhe dokumentet kadastrale;
3. Dëshmia se prona nuk është në kontest dhe procesverbali për vënien e lokacionit në dispozicion;
4. Projekti kryesor i aprovuar, paramasa dhe parallogaria, raportet gjeodezike dhe gjeoteknike;
5. Leja e ndërtimit, kushtet ndërtimore dhe pëlqimet mjedisore, infrastrukturore e të rrjeteve;
6. Kontrata, sigurimi i ekzekutimit, sigurimet e tjera dhe dokumentet e operatorit ekonomik;
7. Vendimi për caktimin e Menaxherit të Projektit dhe vendimi për caktimin e Koordinatorit Komunal;
8. Kontrata ose vendimi për Mbikëqyrësin;
9. Plani dinamik, plani i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, plani mjedisor dhe plani i menaxhimit të trafikut, kur kërkohet;
10. Konfirmimet e ndarjeve buxhetore për vitin e parë dhe planifikimi në KASH për dy vitet pasuese;
11. Procesverbali i gatishmërisë për fillim, i nënshkruar nga Palët.